

## INTERVISTË ME JEHONA GJURGJEALËN

Prishtinë | Data: 18 maj, 2017

Kohëzgjatja: 57 minuta

Të pranishëm:

- Jehona Gjurgjeala (E intervistuar)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Jehona Gjurgjeala:** Unë jom Jehona Gjurgjeala. Jom drejtore ekzekutive e Organizatës “Toka”.

**Aurela Kadriu:** Jehona, a mundesh me na folë pak për kujtimet e juja të hershme të fëminisë? Çka mbanë në mend prej fëminisë tande? Prej familjes, prapavijën familjare?

**Jehona Gjurgjeala:** (Buzëqeshë) Po keshi se memorja jeme osht’ kështu jashtëzakonisht e dobët, kështu që t’kqyrim çka po m’kujtohet. Nana jeme osht’ mjeke edhe ka qenë profesoreshë në Fakultet të Mjekësisë. Babi ishte inxhinier edhe ka punu qysh prej hapjes së, gjegjësisht ka qenë pjesë e ekipit që osht’, osht’ kyç në ndërtimin edhe funksionalizimin e “Kosovës B”, në KEK [Korporata Energjetike e Kosovës] domethonë. Prindt e mi jonë produkte tipike të Jugosllavisë. Gjyshi jem mas Luftës se Dytë Botërore osht’ bo mësus.

Babi jem ka, osht’ rritë në Prizren edhe ka shku në shkollë në Prizren, ku ka qenë nxanës shumë i mirë edhe ka fitu bursën me shku më studiu në Zagreb. Nana ka studiu në Prishtinë, po ni pjesë të specializimit për shembull e ka kry në Beograd. Thjeshtë po mendoj jonë produkti i qasaj andrrës Jugosllave që nëse mëson bohesh ni profesionist i mirë. Kanë pasë vende të punës, te dytë. Domethonë kanë qenë nifarë idile të cilën ata jonë rritë me qat’ botën që ka ndodhë në qato vjet ma t’mira, domethonë të ’60,’70,’80-ve. Edhe kur kanë fillu qëto sene me ndodhë në Jugosllavi, me vdekjen e Titos, me problemet e ’80-tave mandej të ’90-tave, prindt e mi po m’doket minimum nja dhjetë vjet s’kanë ditë me ardhë n’veti.

Sepse, për shembull unë jom rritë me *video recorder* [video regjistrues]. Kemi pasë ashtu kamerë me, me shirit, kemi pasë video player, domethonë ke mujt kasetat me kqyr filma. Kemi shku n’pushim gjithmonë n’deti. Kom shku në kurs të anglishtes. M’i kanë provu edhe do sene tjera po nuk kom pasë talent fort për (qesh) për vallëzim ose për muzikë. Po domethonë jemi rritë me edhe me libra edhe me krejt. Domethonë ka qenë përnime ni, ni asi qysh me thanë, ni idile tipike. Nifarë familje nukleare. Edhe mandej ajo përnierë ia nisi m’u shem. Edhe ia nisi m’u shem...

Unë e maj mend me njimbëdhjetë vjet, s’maj n’mend shumë, por i maj n’mend disa kështu përvoja. Njona ka qenë kur jom kthy në shkollë, në shkollë kom qenë në “Dardani”, edhe ka qenë shkollë e madhe. Edhe ka qenë natyrisht edhe serbisht edhe shqip me paralele të ndame, mirëpo t’njejtin objekt. Edhe jom kthy mas pushimeve dimnore, edhe tash ti mundesh me paramenu, tash s’po

m'kujtohet n'cilën klasë kom qenë... gjithsesi e kom ditë at' shkollë përmendësh. Edhe tash nganë shkallëve te nalt edhe don m'u kthy djathtas me shku me ni koridor edhe përneherë e sheh ni muri i cili osht' ndërto brenda pushimit. Edhe qajo ka qenë domethonë nifarë fillimi i qasaj ndamjes mes serbve edhe shqiptarve.

Ata e kishin marrë gjysën e shkollës, neve na kishin lanë gjysën e shkollës. Na ishim trefish ma shumë nshanës. Ata e kishin ni ndërrim. I kishin marrë krejt karrikat ma t'mira (qesh), tavolinat ma t'mira krejt, e na knej qashtu qysh mujshim me u gjindë. Tash kur je qaq i vogël edhe fort a din s'të len përshtypje. Okej, muri, muri, i grah me tanën edhe nuk ndikon qaq shumë. Mandej e maj men, domethonë senin tjetër që e maj n'men që poashtu nuk osht' që m'ka traumatizu po e maj men, që diku me njimbëdhjetë vjet kom dalë n'protestën teme t'parë. Edhe kanë qenë do protesta ku dilshim me qira edhe e maj n'men, hala e kom ni jakne t'pembe t'killaft me, me, me dyll që ka pikë prej qirit që e kom mbajtë.

Ka qenë qajo e njejta kohë ku u mshojke me teneqe nëpër dritare e qësi disa aktivitete të qatij protestimit paqësor. Seni që e maj n'men që ka qenë traumatik, ka qenë, nanën e patën qitë prej punës, pse qashtu, s'e ka pasë nënshkru lojalitetin [besnikërinë] ndaj shtetit serb. Po ka qenë me ni mënyrë ma e mëshirshme se ça pat ndodhë me babin. Se me nanën u pre edhe tash okej, e tejkalon qat fakt, gjindesh edhe vazhdon tutje. Ajo e pat çel nifarë ordinance ku bojke analiza t'gjakut. A babin prej ni inxhinierit nën menaxhment e patën zhdryp me nifarë posti që ai e përshekrujke, "Si me t'qitë prej Mercedesit në Fiqë". Po përpos që domethonë e kanë, e kanë, e kanë zhvendosë me një post i cili s'ka qenë domethonë adekuat për përvojën edhe pregaditjen profesionale të tij, ça ka qenë ma e tmerrshme ka qenë qajo frika ose qaj tensioni, ose qajo pasiguria që ka ardhë me të shkumen në punë çdo ditë.

Gjithmonë diqysh qajo koha kah tre e gjysë kur u kthejke n'shpi ka qenë pak si nifarë ankthi e ki pasë se, s'e dishe me çfarë, çfarë dite ka qenë, me çfarë energjie po kthehet. Edhe a din qysh ndikon ajo manej në atmosferë në familje. E prapë me qat kohë noshta edhe nuk e vren fort, por me... mas disa... se kjo ka zgjatë 5-6 vjet deri sa une kom qenë aty. Mandej ka vazhdu po une s'kom qenë mo në Kosovë. E kom kuptu ma vonë që shumë ka qenë terrorizuse me ni mënyrë. S'po di, ni sen që nashta muj me përmbledhë ka qenë, shumë ka qenë interesant se ata jonë formu përnime në nifarë ashtu faze, domethonë rinia e tyne edhe faza formative e tyne ka qenë në nifarë lloj idile njerëzore që e ka dhanë Jugosllavia në ni moment të caktum kohor.

Përderisa vitet e mia formative domethonë prej qësaj njimbëdhjetë vjeç e tutje kanë qenë e kundërta. Kanë qenë ni shembje totale e ça osht' e drejtë, ça osht' e padrejtë, ça osht' e meritume ça s'osht' e meritume. Domethonë qysh me thonë, për mu padrejtësia ka qenë fakt i jetës. E ata tash si prind u mundojshin, "Jehona, a din, kqyr ki kujdes, se jeta nuk osht' e drejtë a din, edhe ndodhin sene të vështira". Une isha ashtu, "Pff, pash Zotin", po meno, "po p'e di". Kështu që me ni mënyrë edhe pse ka qenë vështirë edhe përnime shumë sende qysh ndrron jeta prej qatyne rrethanave jonë të parevokushme. Së paku s'e kom pasë nevojë, s'kom pasë nevojë m'u ballafaqu me faktin që jeta osht' e padrejtë, a din, përderisa ata muj me thonë deri diku nja pesë vjet mas luftës kurqysh nuk mujshin m'u pajtu me ça ndodhi. Osht' pikëlluse me pa...

**Aurela Kadriu:** E përmendët punën e murit n’shkollë. A mundesh me na tregu qysh ka ndiku qëkjo në raportin e juj me shokët edhe shoqet e nacionalitetit serb? Mënyra e pasqyres... a keni pasë raport paraprakisht të mirë?

**Jehona Gjurgjeala:** Po. Kqyre une çka e maj n’men osht’ që, tash na kemi jetu në banesat e KEK-ut. Domethonë krejt familjet që kanë qenë aty e kanë pasë dikun t’punësum në KEK. Edhe në ndërtesën tonë ndoshta nja 25-30% kanë qenë serbë, pak a shumë n’secilin kat ka qenë ka ni familje serbe. Nuk osht’ që kemi pas kumedit çfarë miqësie, po për shembull une e maj n’men e kom pasë ni fazë kur kom mledhë salveta [faculeta letre] edhe kemi shkëmby. A, edhe unë e kom folë serbishten edhe ka qenë super lehtë me komuniku edhe ka qenë ni raport shumë fëminor, a din, as që e ki mendu, kush osht’.

Prindt e mi kurrë nuk kanë, nuk kanë bo qasi ndamje ose etiketimi t’njerëzve në bazë ose nacionaliteti, ose katunar/qytetar, edhe qësi sene që kanë ekzistuar edhe ekzistojnë. Po definitivisht me ni moment të caktum, une nuk e maj n’men si t’preme, veç e maj n’men që dikur me ni moment mo diqysh s’u bo puna me nejt me ta... po flas për fillim. Mandej qëto puna me salveta po flas kur i kom pas 8-9 vjet që p’i bjen diku në fund të ‘80-tave, e mandej n’fillim të ‘90-tave. Edhe kom hi domethonë n’fazën e tinejxherizmit [adoleshencës]. Shkolla e mesme... aty veç, veç ke qenë shumë ma i vetëdijshëm për vetveten, për çka don, çka, çka munesh e çka s’mundesh për shkak se që, për shkak që je shqiptar edhe ka ndiku definitivisht në...

Tash prapë për shkak që e kom kuptu që *life’s not fair* [jeta nuk është e drejtë]. Nuk u konë që une tash diçka kom pasë naj inat, po ki lakmu definitivisht. Kanë qenë do rregulla shumë të pashkrume. Kurrë s’e, s’e di, tek ma vonë e kom kuptu qysh jemi organizu, qysh kemi lëvizë, qysh kemi jetu, pa të thanun, po krejt e kemi përcjellë qato t’njejtat rregulla. Për shembull, une jom rritë në Dardani. Une s’e maj n’men që kom kalu përtej rrugës Goleshit, ku osht’ kino ABC-ja sot, ku kanë qenë zyret e “Postpesimistave”. Nuk e kom ditë hiç çka ka përtej, *like* hiç, hiç, hiç. Për mu qyteti jem ka qenë Kurrizi. Qaty Dardania, Kurrizi. Qaty kemi dal, qaty jemi shoqnu. Jo përmbi Kurriz, jonë do kafiqa të Kurrizit... pak te tri, “Tre Sheshirat”, “Tri kapelat” ka qenë nifarë “Xhani”....

Edhe domethonë veç dej te “Postpesimistat” kemi shku. Përndryshe, domethonë je vetë organizu edhe je vetë limitu në qat’ hapësirë. Unë kom qenë në “Xhevdet Dodë”, kështu që edhe ajo ka qenë në qat’ anë të Prishtinës. Seni tjetër ka qenë që mas [orës] 11 s’ke nejtë kurrë jashtë, a për shembull serbët dilshin mas 11-ve.... Po menoj njo prej arsyeve pse kom qenë qaq entuziaste për “Postpesimistat” ka qenë se qashtu qysh ja nis kadal-kadale me pasë ma shumë kureshtje, me pasë dëshirë me eksploru, me bo sene, e s’munesh. S’munesh me shku në bibliotekë përshkak se, se je shqiptar. S’munesh me shku në “Boro Ramiz” ku kanë qenë qito, ka qenë qendër kulturore, pse je shqiptar. S’munesh me shku n’bazen [pishinë] për shkak se je shqiptar.

A din ja nis dikur me thanë, a din, oh se s’ki çka bon me vetveten, edhe natyrisht që e ki nifarë idhnimi, po *Life is not fair* [Jeta s’është e drejtë] edhe munohesh m’u gjindë qysh munesh. Une kom lexu shumë. Kom pasë, për shembull qëkjo ka qenë edhe njo prej qatyne pasojave të qenit me ni familje

profesionale që ka qenë ashtu produkt, prototipe jugosllave. N'shpi te une osht' lexu. Babi jem lun shah. Për shembull ka qenë "Politika" nifarë gazete ditore që osht' në çirilicë. E ka pasë nifarë seksioni të shahut, e ai e blejke për qata. E jom mësu qashtu me lexu çirilicën. Kështu që mandej kom mujt m'i ble edhe librat që jonë çirilicë. Enciklopediat... ka qenë nifarë reviste rinore tepër ashtu, me kuriozitet, për astronomi, për psikologji, për çkado. E kanë qenë të qasshme për mu. Kështu që kom mrrri mos me metë krejt jashtë. Po, megjithatë osht' ni limit i asaj se çka munesh me absorbu, me përjetu, edhe m'u zhvillu veç t'u lexu. E krejt këto senet tjera kanë qenë t'pamunduna.

**Aurela Kadriu:** Mas vendosjes t'murit n'shkollë, a ndërroi diskursi i ligjerimit prej profesorëve, po m'intereson?

**Jehona Gjurgjeala:** S'e maj men drejtën me t'thanë. Po thom kur u nda qaj muri kom qenë shumë e vogël, edhe po t'thom e kom marrë ashtu si, "Oh, OK", edhe i kom grahë, nuk e maj n'men.

**Aurela Kadriu:** A e mban n'men qysh ka qenë diskursi i ligjërimit n'shkollë t'mesme? A ka pasë nuanca nacionaliste?

**Jehona Gjurgjeala:** Pfff.... Po, po, s'po di as, as...

**Aurela Kadriu:**... edhe tekstet me t'cilat keni mësu n'shkollë t'mesme?

**Jehona Gjurgjeala:** Paj, nuk osht' që kom naj, naj, domethonë s'po më kujtohet naj shembull që ka qenë qaq diçka eklatant. Po e kena pasë profesorin e historisë, që gjithë hike... ka qenë po m'doket me Ballin Kombëtar, e nonstop hike nëpër do, do filozofina ashtu te idealizimit të shqiptarve edhe sakrificës shqiptarve, edhe krejt ktyne seneve, si populli ma i përkrym, e ma i mirë, e ma fisnik e krejt, që edhe atëherë m'u kanë dukë banale. A ka pasë ashtu shumë muhabet ça po na bojn shkijet? Ka pasë, po nuk o që diçka fort me majt n'men. E maj n'men, a din qysh, kur e ki, qëkjo osht' qaj elementi që kur e ke, e kom pasë....

I dashuni jem i parë ka qenë prej Irlandës Veriore, edhe qaty e kom pa që, që njerzt që rriten në *low intensity long term conflict* [konflikt i gjatë me intensitet të ulët], domethonë qëto konfliktet që zgjasin shumë gjatë, po nuk janë, nuk osht' luftë, nuk jonë t'u ra bombat prej qiellit çdo pesë minuta, thjesht bojnë çka duhet m'e bo, për me e mujt me e, me e, me e jetu sa ma mirë që osht' e mundshme. Kështu që ndodhin qëto sene.... Po une maj n'men në shkollë qysh kom shku edhe kom muj, munu me bo taktika qysh me mujt m'i marrë krejt pesëshe. Tash, ka ndodhë najhere që dikush ka fol diçka, po nuk osht' që fort. S'paku ja kom vnu veshin une a, për qato s'po më kujtohen. Përpos qështu që p'e përmeni Sahitin e historisë, që ka qenë ni njeri jashtëzakonisht i mirë, po, qështu i ka pasë tripat nationalist.

**Aurela Kadriu:** A mundesh me na tregu për qët' periudhën e shkollës t'mesme qysh ka qenë, krejt ni pasqyrë të gjanë? Qysh ka qenë kur ju keni dalë natën, kur keni dalë ditën? Qysh jeni mledhë, çka keni bo aktivitete? Çka keni bo n'shkollë t'mesme?

**Jehona Gjurgjeala:** Kështu, na jena ndi tepër të privilegjum, se kemi qenë në “Xhevdet Dodë”. Ka qenë e vetmja shkollë që ka qenë në objekt, qasi çfare ka qenë, edhe në ni mënyrë kanë qenë nxanësit ma t’mirë, prej familjeve ma t’mira, me thonë a.... Tash po flas prapë për qëto asi, që e ka kriju megjithatë ni, ni, ni ndjenjë të komunitetit, a din. Kështu që, si tinejxher e ki, e ki përjetu a, qashtu qysh e përjeton tinejxheri shoqinë. Veç qajo t’intereson: shoqnia, shoqnia, shoqnia. Kështu që për shkollë, thjeshtë e maj n’men si normale me thonë a. Tash ti normale i ki qato referenca që i ki, a din, që me t’diktu dikush m’e shkru ti, qajo osht’ me mësu. Po për mu ka qenë, para “Postpesimistave”, për mu ka qenë tepër e randë qëky aspekti i mos, mosmundsisë me e ushqy kuriozitetin tem edhe me mësu sene, edhe me provu sene, për shkak se ka qenë qaq e izolome, qaq e limitume.

Ka qenë, në kishën katolike, ka qenë ni, ni djal i ri Ilir Rodiqi e ka emrin, osht’ arkitekt. Edhe ai n’çdo t’dille na ka mledhë ni grup t’rive, kushdo që ka dashtë me shku a. Domethonë s’ka qenë, s’di as vet qysh e kom marrë vesh, po, ni herë në javë kemi shku edhe kemi fol. A din, s’ka pasë kurgjo tjetër, veç kemi shku edhe ai na ka bo ni pytje si për shembull, “Çka menoni për Beatles-at?” A din. Edhe ti tash ki bo, ki disku për qat’ sen a din. Edhe po t’kallxoj domethonë sa ka qenë ajo primitive, edhe kom shku absolutisht, rregullisht me shumë qef se veç me t’pyt dikush diçka edhe me bo muhabet me tjerët, ka qenë diçka, a din, ka qenë me vlerë..

Këta mandej e kanë pasë nifarë gazete që e bojshin rinore, edhe qaty, po menoj qaty... bile Jetën qaty e kom njoftu, t’u e bo ni gazete, t’u i bo fotografitë, artikujt, çka po di une, qësi sene...

**Aurela Kadriu:** Cilën gazetë?

**Jehona Gjurgjeala:** “Shpresa” e ka pasë emrin. Ça po du me thanë osht’ që, po menoj në qët’ aspektin, qysh ka qenë jeta si tinejxher, n’shollë ka qenë qysh ka qenë. Ke menu që i ki punët super mirë se ki qenë në “Xhevdet Dodë”, me nxanës t’mirë edhe me objekt t’mirë. Arsimitarët kanë qenë qëllim-mirë në përgjithësi. Kur i kujtoj qëtash, do kanë qenë ma pak, do kanë qenë ma komp... ma kompetent, po kanë qenë qëllim-mirë. Ashtu s’munesh me, me ia nxanë, për, me ia nxanë për t’madhe pedagogjinë. Qajo jeta jashtë ka qenë shumë e ranë. Qëto fakte që s’ki nejtë ma vonë ose s’i ki, s’i ki ditë që as jonë limitime, qashtu qysh thashë. Tash ki pasë ti momente ku kanë qenë ashtu shumë, *creepy* [të çuditshme]. Ashtu, tepër t’randa.

P’e, p’e kallxoj ni rast. Ka qenë... kom qenë me do shoqe t’u zhdryp teposhtë, ku osht’ tash kisha katolike te “Tre... “Tri kapelat”, në drejtim të nënkalimit, edhe po ecim na. Kurgjo, po ecim edhe po folim. Edhe tash tinejxhera t’animum, la-la-la, edhe kemi qenë t’u e kalu ni kafiq. I ka pasë disa karrika jashtë, edhe qysh kom qenë t’u fol me shoqet e mia, po a din, t’animum, veç kur e kom ni, ni za t’u ma ba, “*Hej mala tiše malo*” me shumë agresivitet, që në serbisht i bjen, “Hej ti çikë, fol ma me t’ult”. Edhe e kom kthy kryt e kom pa ni qasi, i thojshin dizellasha. Jonë konë do ashtu djem t’ri që u veshshin njejtë. Ka qenë nifarë profili i “barabës” atëherë. Edhe, edhe jom kthy e kom kqyr edhe veç kom bo “*Izvini*” [më fal]. Ashtu instikti jem i parë ka qenë m’i kërku falje.

Edhe kom vazhdu. Edhe ai ashtu kishe, “Hajt po ta fali po mos m’lodh ma shumë”. Edhe na kena vazhdu me ecë, edhe po menoj që e përmeni mas 20 vjetve, edhe e maj n’men edhe qatherë, se si me

thonë tre-katër hapa ma poshtë i kom bo edhe jom konë ashtu, “Çka m’shtin mu m’i kërkuj falje dikujt, që osht’ banor i njejtë si une, në qët’ qytet, qëkjo rrugë m’takon mu qaq sa i takon atij!” Edhe m’vike inati prej vetes, pse instikti jem ish m’u zvogëlu edhe me kërkuj falje. A din, thjeshtë m’u ni si i, i privilegjum që po t’len me marrë frymë n’qytetin tond. Ka qenë rond, ka qenë rond, qaq sa nalesh edhe mendon, po natyra e njerit osht’, a din, e tillë, që ia bon vetit sa ma shumë lula, se përndryshe, osht’ vështirë me mbijetu, osht’ vështirë me dalë prej shpisë.

**Aurela Kadriu:** Qysh ka qenë raporti juj me bashkëmoshatarët tjerë që rishin nëpër shpi-shkolla, ndërkohë që ju ishit në objekt?

**Jehona Gjurgjeala:** Une kom pasë aty-ktu... në “Postpesimista” domethonë kanë qenë disa nrxanës që kanë qenë edhe në “Sami Frashër”, por jo shumë. Kena pasë nifarë arrogance na definitivisht. Po menoj mu m’kujtohet ni njeri që ka qenë në “Sami Frashër”, ni çikë. Nuk e kom dashtë fort, po s’ka qenë pse s’ka qenë, pse ka qenë në “Sami Frashër” (qesh), po ka qenë qashtu, e lazdrume... Nuk e di, duhesh me vet najkon tjetër që ka me thonë ma shumë për këtë send. Po çka e maj n’men osht’ që përnime jena ndi jashtëzakonisht *special* [të veçantë] që jena në “Xhevdet Dodë”.

**Aurela Kadriu:** Qysh ka ndodhë mandej inkuadrimi juj në “Postpesimista”?

**Jehona Gjurgjeala:** Une qysh e maj n’men osht’ që Petriti ka ardhë klasë m’klasë. Ai ka pasë qenë me ni konferencë qështu rinore. E ka bindë qat’ grun që osht’ në Norvegji, Kristinen, me organizu ni, me thonë konferencë, ose ni mledhje t’rive, po prej Ballkanit, prej ish-Jugosllavisë. Edhe si duket, domethonë, ka qenë t’u realizu qaj sen.... Edhe une veç e maj n’mend që ka hi klasë m’klasë edhe t’u thonë, “po m’vyjnë nrxanës t’mirë që dinë anglisht”. Edhe une kom qëllu n’qat’ klasë. Garentina ka qenë n’qat’ klasë. Qështu po get i ka mledhë edhe nëpër klasë tjera. S’e di, qëkjo m’kujtohet. Edhe mandej kemi nisë m’u mledhë. Jemi mledhë nëpër shpia, ni kohë bajagi t’gjatë. Edhe mandej ka vazhdu....

**Aurela Kadriu:** Qysh e kishe për...përshkru ma s’pari krejt qët’ periudhën në “Postpesimista”? Fillimisht dinamikën e ngjarjeve, aktiviteteve postpesimiste, kështu?

**Jehona Gjurgjeala:** Për mu “Postpesimistat” kanë qenë, thjesht m’kanë dhanë jetë. S’muj me përshkru çfarë impakti, përpos domethonë atë që ka ndodhë që e kom taku dikon, në kuadër të “Postpesimistave”, e kom taku dikon që, ma ka gjetë ni bursë me shku me studiu në Angli. Edhe ka ndërru jeta jeme në qat’ mënyrë. Qajo kohë që kom qenë me “Postpesimista” ka qenë e hatashme sa i përket eksitimit që kom pasë që jom e rrethume me ni grup t’rive që jonë si une qashtu, intelegjent, kurioz, energjetik, pa komplekse, ashtu të untë për gjithçka. Edhe të njejtën kohë je ni, je ni pjesë e diçkafit, edhe të njejtën kohë je ni i sfidum. Nuk osht’ që jom ni e sfidume, po shumë ka qenë, shumë ka qenë ushqyse. Thjeshtë, s’po di diçka me vizualizu osht’ si me të, si me të eksplodu kështu rrezet e energjisë n’tona anët prej nifarë lloj thatësie të nifarë realiteti që ka qenë.

Domethonë seni i parë që muj me të thonë osht’ që ka qenë jashtëzakonisht energjizuse, jetëdhënëse, shpresëdhënëse... ta ka dhanë ni qëllim, qëkjo ka qenë njo. Aspekti tjetër ka qenë, që ka qenë

jashtëzakonisht e dobishme prej aspektit edukativ a? Domethonë prej seneve që s'e ke ditë që je t'u i mësu, po që je t'u i mësu, me organizu, m'u koordinu, me planifiku, me gjetë zgjidhje, çkado. E deri te senet që i ke mësu, ke pasë punëtori të gazetarisë, ki pasë punëtori të fotografisë, domethonë qështu jonë konë do sene. Une kom qenë ma shumë ashtu në fotografi e kyçun. Ki bo intervista... une për shembull e kom ni gazetë ku kom bo intervistë me Ardit Gjebrean me, me, me 15 vjet a 16 vjet n'both diqysh.

Edhe t'doken normal ato sene. Mandej, ni sen që ka qenë jashtëzakonisht i çmushëm, ka qenë qajo mundësia me udhëtu, edhe që i ka pasë dy, dy dobi shumë t'mdhaja. Njona ka qenë që ki dalë, ki pa me ni moshë jashtëzakonisht të re, ku shumë ka qenë me randësi, edhe e dyta ka qenë që ki pasë domethonë rast me nejtë me bashkëmohatarët e tu prej krejt qëtyne Republikave të ish-Jugosllavisë. Edhe, edhe t'ka ra me ni mënyrë shumë t'natyrshme me i pa si njerëz dhe m'i pa si tinejxhera, si ti. Edhe ka ndihmu mos m'u kriju qajo që osht' shumë nifarë sëmundje në Ballkan, që osht' që i tjetërzojmë krejt, në kuptimin, "Ah, këta jonë serbë, edhe këta jonë qështu, shqiptarët jonë qështu, kroatët jonë qështu".

E, e kupton që jo. Krejt jonë njerëz. Edhe a din, i ka hekë do qësi paragjykime, i ka hekë disa rezistenca ndaj, ndaj njohjes që jo veç në raportin me, me, domethonë me qita, qito, kombet e ish-Jugosllavisë, por edhe kur kom shku mandej në Angli, ku ballafaqohesh me raca të ndryshme, me kultura tjera, m'ka ndihmu që, a din, me u gjindë, m'u orientu në qat' sen, e mos me metë ashtu si, "Haa?" Si ni, ni, ni mendjembyllun. Kështu që, absolutisht ka qenë transformative.

**Aurela Kadriu:** A kishe mujtë me na përshkru pak ma shumë detaje, nëse t'kujtohen aktivitetet që i keni bo në "Postpesimista"? Krejt procesin e aktiviteteve, qysh i keni pasë, qysh i keni përjetu?

**Jehona Gjurgjeala:** Ah, mu nuk më kujtohet n'detale prapë po thom, jo. Muj me të kallxu kështu elemente që po m'kujtohen kur kemi bo gazetën. Kemi pasë takime të redaksisë, i kemi nda punët kush çka po bon, tek po bon. Elementi që ka qenë interesant definitivisht, si prej aspektit të mentorimit për gazetari, po edhe thjeshtë me mësu për qysh, qysh shkojnë punët, ka qenë bashkpunimi me "Kohën Javore" atëherë. Se ata kanë qenë si me thanë botuesit tonë, po edhe domethonë, gazetarët edhe redaktorët e "Kohës Javore" jonë marrë me neve. Kanë qenë nifarë si lloj, na kanë redaktu artikujt, na kanë dhanë *feedback* [sygjerime].

Kemi kalu kohë edhe t'libër bashkë. E qajo ka qenë interesant, se kanë qenë karaktere jashtëzakonisht interesante, shumë t'llojlojshme edhe shumë njerëz të meçëm. Po, e ki pa qysh çka ndodhë në botën e t'rritunve në ni ma... në ni fazë ku ki qenë hala i vogël. Kanë qenë, ka qenë, qysh me thanë, mësim, që kanë qenë shumë t'dobishme që m'i mësu qaq, qaq, në qasi moshe të re... Po duhesh me vetë dikon që mban n'men ma mirë. S'po m'kujtohet kështu mekanikat e seneve.

## Pjesa e Dytë

**Aurela Kadriu:** Jehona, a i mani n'men qysh u konë procesi i udhëtimit? Sfidat me të cilat jeni përballë?



**Jehona Gjurgjeala:** Une kom qenë, s’po, po m’kujtohen nja tri... drejtën me t’thanë mu nuk po m’kujtohet që e kom pasë naj sfidë t’madhe. Jom prej natyrës shumë kurioze, kështu që kur e shoh dikon që s’ish dashtë me m’pëlqy pse osht’ serb për shembull, mu m’intereson kush osht’, tek osht’, e me ba muhabet. Kështu që nuk m’kujtohet që kom pasë najfarë aversioni a najfarë rezistence t’madhe ndaj dikujt. Ka pasë definitivisht, ka pasë, e maj n’men, ka pasë asi diskutime t’randa. Njerëzt i kanë mëshu tavolinave, jonë çu n’kamë, kanë dal jashtë, po unë i maj n’men si tepër, tepër përvoja pasunuse.

Shembull, njonën prej pro... programeve, kampeve që kom qenë, ka qenë në Austri. Qaty jonë disa fotografi, ku kemi mësu me foto, me bo foto edhe me bo ashtu, taman bardh e zi, m’i fotografu n’film, m’i zhvillu nëpër krejt ato, langjet e ndryshme, e kemikalet e ndryshme. Edhe kur te bon qat’ sen, për shembull, qëtash kur p’i kqyri fotografitë osht’ aty ni kroat, osht’ ni boshnjake, osht’ ni serbe, osht tepër diqysh organike a. Une e kapi e nxerri ata prej ksej, ia jap asej, ai e bon, tek e bon, ka qenë, po menoj ka qenë super transformative.

**Aurela Kadriu:** Une e di që ka pasë “Postpesimista” edhe në vendet e tjera të Ballkanit. Nëpër cilat vende ka pasë ma s’pari, edhe a keni pasë kontakt me ta? Qysh ka qenë kontakti me ta?

**Jehona Gjurgjeala:** Ka pasë. Në Suboticë osht’ hala, në Vojvodinë domethonë, osht’ ni grup që osht’ hala aktiv. Tash “Postpesimista” ka pak a shumë n’secilin kryeqytet të ish-Jugosllavisë. Domethonë edhe në Zagreb ka, edhe në Sarajevë ka, edhe në Beograd ka, edhe Suboticë ka, edhe këtu ka. S’ka pasë maqedon, s’ka pasë slloven, kështu që, domethonë jonë prej qëtyne, qëtyne vendeve. Tash a jonë ata të organizum qashtu si “Postpesimista”? Po m’doket, përpos në Suboticë që jonë disa entuziasta që hala e kanë nifarë faqe të *Facebook*-ut, nuk ka. Po menoj jonë njerzt të qkepun nëpër jetnat e tyne.

**Aurela Kadriu:** Atëherë qysh ka qenë kontakti juj me ta?

**Jehona Gjurgjeala:** Kqyre, njerëzit e ndryshëm kanë pasë, kanë pasë kontakte t’ndryshme. Po menoj ka pasë edhe lidhje, dashni që jonë bo mes, mes grupeve të ndryshme. Une për veti shumicën e kontaktit e kom pasë gjatë kampit. E di që i kom do letra prej, disa prej, ish pjesëmarrësve që m’i kanë dërgu. Sigurisht që edhe une ju kom dërgu, po n’përgjithësi nuk osht’ që kom, kom majtë kontakt fort me të tjerët.

**Aurela Kadriu:** Mandej qysh ka vazhdu jeta juj mbas “Postpesimistave”?

**Jehona Gjurgjeala:** Po, në “Postpesimista” patën ardhë ni çift tepër interesant, po menoj shumë kështu jo tipik. Ni anglez edhe ni angleze të pensionum. Kanë qenë kuejkera [*quakers*]. Kuejkerat jonë nifarë denominacioni protestant që jonë qështu pacifist, jonë tepër ashtu, jonë pacifista. Besojnë në barazi edhe jonë qështu aktivista t’mdhej për njerzim. Edhe që ata dy pensionerat e kanë pas ni *Land Rover* ashtu antik edhe kanë vendosë që s’po dojnë me nejtë në Angli, po, po dojnë me u endë nëpër ish-Jugosllavi edhe me bo aktivite qështu *reconciliation* [pajtim] me t’ritë. Edhe s’di qysh kanë mrrri

te na në zyre, po erdhën i bonën do aktivitete. Kenë asi aktivitete që për neve ishin jashtëzakonisht fëminore, se na shumë shpejt u rritëm. Ashtu çka po di une, m'u gjunjëzu, m'i kap durt edhe manej t'u çu n'kamë me bo *love* [dashuri] me piskatë [bërtit], që i bojshim na se jonë musafir, e ia bon qefin musafirve.

Po kena ashtu, kikiki {onomatope} t'u kesh, po megjithatë kenë shumë të lezetshëm. Edhe unë, bash une edhe Garentina edhe ni shoqe tjetër Ariana, i çum qëtu, a ka qenë Punto, a ka qenë qështu diçka si Punto... bash qëtu përfundi, i patem çu me pi ni pije, ni kafe, ni çaj, çka po di une. Edhe në qat' muhabet, si falenderim a, edhe në qat' muhabet folshim qysh jonë rrethanat, qysh osht' shkolla katastrof, qysh fakulteti osht' nëpër shpia, çfarë prespektive e dobët osht'. Edhe ajo në ni moment pa asnji agjendë a, po ajo në ni moment ka bo, ka bo une kom m'i shkru shkollave të kuejkerava në Angli edhe kom m'u munu me ju gjet bursa me shku në fak... me shku n'shköllë. Edhe kejt ashtu, "Okej, *nice* [mirë], falemnderit". Po prapë ashtu "S'bohet kjo kurrë!" A din?

Po, ajo gruja, dorën në zemër e majti fjalën. Edhe domethonë jonë do shkolla private që jonë themelu para 200-300 vjetve në Angli që jonë domethonë e qëtij denomi, denam, de, de, denominacioni edhe ajo iu ka shkru atyne shkollave. Edhe, edhe njona prej tyne e ka ofru ni bursë, edhe une kom qenë personi që ashtu pak ma shumë kom majtë kontakt me to. Edhe kom pasë dajë të nanës në Londër që ka mujt me qenë si *guardian* [kujdestar], se u dufke dikush gjatë pushimeve edhe mundesh me shku te ata. Edhe pata shku. Edhe kom shku mrena javës. Veç m'ka ardhë ashtu mesazhi, "E ki bursën, shko!" Edhe kom qenë në Greqi bile, me nifarë qësi programi të "Postpesimistave", edhe m'ka ardhë nana m'ka thirrë edhe m'ka thonë qështu qështu, osht' bo.

Jom kthy brenda 2-3 ditëve në Prishtinë. Kom shku në Beograd me marrë vizën. Ia kom dhanë letrën asaj grusë në Ambasadë, edhe ka shku e ka kontrollu diçka mrapa, edhe kur u kthy jom shliu shumë se m'u duke krejt si andërr, a din. Momentin që u kthy diqysh kom thanë, "Okej po ekzistojka shkolla", se s'ki pasë internet atëherë, s'ki mujt m'i kontrollu këto sene. Bukfalisht, a din, thojsha, "Ku po shkoj?" Edhe u bo viza. Edhe për ni javë ditë m'ka ndërru jeta plotësisht. Kom m'rri me ni shkollë, edhe shkolla ka qenë krejt çika. Edhe unë qaty kom jetu, kom mësu, kom hangër, kom pi. Ka qenë totalisht ni shok kulturor, po qështu ka vazhdu manej.

**Aurela Kadriu:** Qysh ke atje, a e mban mend shkollën, përpos faktit që ke jetu me çika, edhe... ?

**Jehona Gjurgjeala:** E maj n'men shkollën. Ka qenë tepër mirë edhe tepër vështirë n'do aspekte... unë kom qenë shumë shumë e varfën a. Kom folë me prindt e mi ni herë në javë 5 minuta, çdo të dille. Edhe qaq pak kemi pasë pare sa që une ni vjet s'jom kthy në Kosovë. E me 17 vjet kur kurrë s'ki qenë jashtë, s'ki jetë, domethonë s'ki qenë larg familjes ma shumë se dhjetë ditë, mos me mujt m'u kthy ni vjet... Ma vonë e kom kuptu sa ka qenë vërtetë vështirë ajo, po qashtu ka qenë. Kom pasë ni parë farmerka edhe ni parë këpucë për dy vjet që kom qenë aty. I kom ly çdo 6 muj. I blejsha, jonë do kutia me ngjyrë, i shtin n'maçinë edhe farmerkat jonë t'reja, edhe....

Mësimi ka qenë supër i lehtë, se e bojnë lehtë. Ma s'pari klasët i kanë ka gjashtë, shtatë veta. Osht' diskutim, osht' sfidus, osht' miqësor. Po a din, për shembull në sociologji mësojshim për sektat, tu

kqyr ni film... ni film me do, ni sektë që i adhuron gjarpijtë. Tash normal që e mëson ma lehtë senin kur e ki qaq lehtë të prezentum. Kështu që shkolla kurrë s'më u ka dukë vështirë. Po une n'momentin që kom mrrri, unë kom pasë vendosë që po du me metë për fakultet, e me metë për fakultet m'u dish... kisha nevojë m'i gjetë përmi 50 mijë euro për me pagu qato 3 vjet fakultet.

**Aurela Kadriu:** Ehem... a rrim veç pak... n'cilin vit ka ndodhë kur ke shku në Londër?

**Jehona Gjurgjeala:** '96.

**Aurela Kadriu:** A ktheheshe për pushime mandej mas vitit t'parë? A vishe për pushime në Prishtinë?

**Jehona Gjurgjeala:** Po.

**Aurela Kadriu:** A mundesh me na përshkru pak qat' periudhë, qysh ka qenë kur vishe prej Londrës në Prishtinë?

**Jehona Gjurgjeala:** Domethonë, që '96, '97. Vera. Kqyre vera e '97-tës s'o që po m'kujtohet fort. Vera e '98-tës definitivisht m'kujtohet se e pata kry vitin e parë t'fakultetit. U pata kthy t'u menu ashtu okej po vi m'u knaq verën me kalu në Prishtinë. Edhe kur pata mrrri këtu veç ia pat' nisë lufta, domethonë luftimet e mbrenshme në Drenicë. Edhe Garentina, për shembull Fisi, domethonë, e krejt qëta, ni pjesë e shoqnisë të "Postpesimistave" patën nisë me shku n'teren ose si gazetar ose si *fixera* ju thojshin për, për gazetarë t'huj. Edhe mas nja katër, pesë dite që pata qenë në Prishtinë, diqysh pata thanë une s'muj me nejt këtu me pi birra në Prishtinë, ku 30 kilometra ma lart, larg po ndodhë diçka qashtu.

Edhe pata vendosë që po du edhe unë me, me shku me, me bo qat' sen. E pata bindë Baton Haxhiun me m'marrë nihere, se thojsha me bo m'i shku BBC-së e me ju thonë unë jom *fix*, une muj me konë *fixer*, e pa dalë asniherë në teren, pa e pa katunin me sy... Se unë krejt familjen e kom prej Prizrenit, kështu që s'kom pasë kurrfarë rasti me njoft Kosovën realisht, me thonë rurale, thojsha keshin me mu. E thirra Batonin Haxhiun, i thashë, "Po du me dal n'teren, a m'merr?" Me 19 vjet ashtu. "A je e sigurtë?" Thashë, "Po". Tha, "Hajde". Edhe qështu nja dy-tri, dy-tri javë kom dalë me Batonin edhe kom shkru për "Kohën Ditore". E mandej kom fillu me punu me t'hujt, edhe kom vazhdu tonë qat' verë, që ka qenë vera ma bizare n'jetë.

**Aurela Kadriu:** A mundesh me na përshkru?

**Jehona Gjurgjeala:** Oh... shumë ka qenë, shumë ka qenë jashtë... Je çu n'sabah edhe ki hyp në kerr t'blindum. Kaniherë s'ka qenë i blindum. Edhe je nisë. Zakonisht e ki pasë ni ide ku po don me shku, po s'e ki ditë sa *checkpoint* [pika kontrolluese] ki m'i pasë. S'e ki ditë a kanë me qëllu serb a kanë me qëllu shqiptar. Këta shqiptartë a kanë me të qëllu katunar, çka po di une ni katunar që e ka gjetë ni allti edhe tash po bohet shuf, a po të qëllonjë përnime UÇK-ja? Ka mujt me qëllu, (kollitet) ka mujt me qëllu UÇK-ja paradite, serbët masdite {pinë ujë} ose anasjelltas. Ki pasë raste ku ki mrrri te, te *checkpoint*, me serb, me milici, kanë qenë t'pitë. Me qato alltiat e tyne me sene, normal t'u ka dokë, normal t'u ka dokë. Edhe tash ti domethonë e ki bo krejt qët' sen...

Për shembull, disa elemente që m'kujtohen, ka qenë nihere, e pata marrë informatën që osht' si nifarë spitali i improvizum që ka qenë në një shpi pa dyrë, pa dritare, pa kurgjo, veç beton. Po ni hapsirë e sigurtë në cilën osht' nifarë spitali i improvizum. Edhe s'po m'kujtohet me çfarë gazetarë pata qenë, po u patëm nis qështu. Edhe në njonën prej *checkpointave* pata hasë në Fehmi Lladrovcin. Edhe ai tepër ashtu agresiv. Jo, s'di, kish ndodhë diçka edhe ish shumë ashtu, "Ju gazetartë, ju veç po vini, p'i kqyrni bothën e ju, kurgjo s'jeni t'u bo për neve." E, a din, "Gjakpirësa!" S'e kish me mu, po e kish me asi... edhe, e une e maj n'men po menoj qët' rast edhe shumë raste tjera t'u negocu, a din, t'u thonë, "Po kadal. Po a po mendon ti që qëkjo duhet m'u ditë, qysh po menon ti që ki me zgjidhë qët' problem vet? A menon që kena ndihmë?"

"Duhet m'u pa, a osht' qatje ni fëmi, që osht' i lëndum edhe që osht' asi..." edhe s'di qe qështu, u bind njeri, na la. Edhe shkum na në qët' spital. Kuku Zot! S'e harroj. Ka qenë ni djal shtatë, tetë vjeç, i shtrimë në kese bukfalisht, me kat, jo qysh pi bjen, po kateter... po, jo, si me thonë prej drejt, prej, e kishin lidh dika, për, si duket për veshkë, edhe veç që qështu rrike {tregon me gjeste si e shtrirë}. Tmerr! Po menoj gjithçka ka pasë aty. Edhe ti i bojshe pamjet, i merrshe intervistat, u kthejshe n'qytet. Nëse ish video reportazh, i nimojshe me përkthim me qëto sene. Edhe manej dilshe pishe ni birra. Në qat' kohë dilshim përballë, qatje ka Dardania, nifarë kafiqi, edhe qëtu u mledhshim krejt gazetarët, krejt *fix-erat*, krejt asi, edhe iu ndajshim informatat çka po ndodhë n'teren. Ka pasë gazetarë, une jo, po ka pasë gazetarë që kanë çu porosi prej Prishtinës n'teren dhe anasjelltas me UÇK-në.

Edhe qështu, rrishe deri në 11. Shkojshe n'shpi flejshe. U çojshë, dilshe prapë qështu. S'e dishe çka t'gjenë. E ka pasë, po menoj, qëkjo ka qenë njo prej ditëve shumë t'randa. Ka qenë ni ditë tjetër kur pata shku me dy gazetarë në Likovc. Serbët e kanë pasë nifarë taktike, kanë ardhë e kanë bombardu niherë prej s'largut fshatin. Fshati u shprazë. Manej kanë hi. E patëm shku në Likovc që ka qenë njo prej qendrave të UÇK-së, edhe patëm bo intervistë me "Gjarpnin" edhe me "Sulltanin". Une tek mas luftës e kom marrë vesh që "Gjarpni" osht' Hashim Thaçi. Kur pat' dalë emrin Hashim Thaçi. Thojsha, "Kush o more ky Hashim Thaçi, çka u bo ky njeri me shku në Rambuje?" Kur e kom pa n'fotografi kom thonë "Aaah, qyky osht' 'Gjarpni'" (qeshë).

Edhe patëm shku me qëta dy gazetarët. Ka qenë ni amerikan edhe ni anglez. Edhe nejtëm shumë vonë, ashtu ke si duket vërtetë ni *like scoop*. Edhe bonëm intervistat e me dytë, a u nijke qysh u afrojke ma shumë e ma shumë. Domethonë këto granatat veç vishin ma afër e ma afër. Edhe kur u nisëm veç filloi m'u terru. Ish muzg e na e kishim xhipin e pablindum, t'gjelbërt, që osht' idiotizem total, se nuk shkon me qasi kerri që duket që osht' si kerr ushtarak. Shumë ka qenë *weird* [çuditshëm] se tash, po vozitim, osht' ka na kap terri, po munohem, po ngutem. Une isha përpara, njeni ish mrapa, edhe njeni vozitke. E këta mrapa e kapi panika, "Oh, po shoh këtu ni ushtar, oh po shoh këtu, oh kanë me na myt, o kjo ngjyra jonë, o Zot, o Zot, o Zot!" Hupi njeri, hupi krejt.

E s'mujsha me besu se ish gazetar i ni, ni, ni gazete shumë prestigjioze të Anglisë, në *foreign desk* [raportues nga jashtë]. S'mujsha me besu që njeri po panikavet kur puna e tij osht' qështu me shku nëpër qësi vena. E une me këtë tjetrin u kqyrshim, qështu, a din, "Ça m'i bo, ça m'i bo?" Dikur qëtu m'erdh {prek hundën}, veç ju kom pas kthy ja pata pasë bo, "*Peter, we're here, we have to get out of*

*here, there's no point in panicking, because it doesn't make it any better, so just calm down*<sup>1</sup>. (Qesh) Po get kur e ka pa ni, ni, ni kokërr prej çikës t'u, t'u, ashtu t'u e rahatu, zaher i erdh marre, edhe shujti. Veç kur ka bo "Ok, but im not a happy bunny"<sup>2</sup> (qesh prapë).

Thashë, "Po na nin fort". Anyway [gjithsesi], qëkjo ka qenë njo, ka qenë... oh, ka pasë shumë, ka pasë shumë qësi sene. Ka qenë, patëm shku, kemi qenë një prej ekipeve t'para që patëm hi në Rahovec masi që e patën djegë. Hala u djegke, hala u djegke. Ka qenë shumë, qajo ka qenë vështirë se, vështirë kanë qenë krejt, po kjo ish, ishin t'u ia shti flakën shpijave, edhe na lanë me hi. Veç kur ka bo, "Keni kujdes se hala ka snajperista!"

**Aurela Kadriu:** A ken' serbë a shqiptarë?

**Jehona Gjurgjeala:** Po po milicia e pat' mujtë UÇK-në, e na shkojshim me nifarë teqe edhe u vozitëm, u vozitëm, edhe e nalem kerrin. Edhe ish ni moment kur u dufke me dalë prej kerrit, edhe ka qenë ni asi momenti, "Oh, Zot!" a din, qëtash veç kur të m'kap ni plum prej dikahit. Po nejse, këtu jom, s'më kapi, *whatever* [sidoqoftë], ka qësi....

**Aurela Kadriu:** Mas sa kohe je kthy mandej në Londër?

**Jehona Gjurgjeala:** Kjo ka qenë vera jeme, (qeshë) a din kur t'kthehesh n'shköllë, "Qysh e ki kalu verën?" Unë e kom kalu qështu verën.

**Aurela Kadriu:** A ke traumatike përvoja m'u kthy mandej në Londër?

**Jehona Gjurgjeala:** Jo ma shumë ka qenë traumatike viti tjetër, domethonë '99-ta, ku s'kom qenë une. Kom qenë në Londër t'u studiu, edhe normal kur kanë dalë prindt në Maqedoni e këto sene...

**Aurela Kadriu:** Qysh ndodhi kalimi prej shkollës t'mesme në fakultet, në qat' periudhën... m'ke tregu ma përpara për vështirsitë që i ke pasë?

**Jehona Gjurgjeala:** Po, po s'po di sa jonë interesant. Une pata vendosë që s'po du me marrë azil, edhe pse me azil edhe mujshë me marrë edhe e kishe shkollën pa pare, se shumë m'u patën gërditë çka bojshin shqiptartë qatëherë. Po menoj tepër, tepër, tepër kanë abuzu me sistemin social në Angli edhe nuk mujsha me pa vetën në qat', në qat' grup. Plus që s'mujshë mandej edhe me u kthy dej sa s'bohen letrat. Po e para ka qenë arsyja kryesore, edhe kurgjo... kom hekë, po menoj kom hekë shumë deri sa i kom gjetë paret. Mandej krisi lufta që e boni edhe ma të vështirë. Nuk e di me m'vetë prapë qëtash qy, "Çu hajde mledhi 50 mijë euro..." tash nuk osht' 50 mijë, tash osht' 80 mijë... po, domethonë, me thonë, "Çu boni edhe gjeja qaren". S'kisha ditë as ku me ia nisë.

**Aurela Kadriu:** A komunikojshë me familjen? Familja a ka qenë në Prishtinë gjatë kohës t'luftës kur ti

<sup>1</sup> Peter, ne jemi këtu, ne duhet të dalim nga këtu, nuk ka vend për panik, sepse nuk është se rregullon diçka, prandaj vetëm qetësohu.

<sup>2</sup> Në rregull por nuk jam lepur i lumtur.

ke qenë në Londër?

**Jehona Gjurgjeala:** Po ata kanë qenë në Prishtinë n'javën e parë, mandej kanë dal në Maqedoni.

**Aurela Kadriu:** A komunikojshë me ta najhere, qysh ka qenë situata?

**Jehona Gjurgjeala:** Po, po, qat' kohë që kanë qenë në Prishtinë, komunikojshim çdo ditë, po qysh me thanë asi tregime tipike të familjeve, "S'kallxojna". Unë tashti "Qysh jeni?" "Qe mirë, mirë, mirë". Të nesërmen, "O qe nana ka dalë në Maqedoni. Edhe une kismet nesër". Prej babit....

**Aurela Kadriu:** A t'ra me u kthy tani verën e '99-tës?

**Jehona Gjurgjeala:** Po, po, (qeshë), po keshi se prindt ishin në Maqedoni, edhe une mrriva prej Londrës në Maqedoni. Po ata hala i mledhshin rakshajat e tre mujve të refugjatllëkut. Edhe thanë "Shko ti përpara se, se po nijmë që p'i thejnë banesat edhe p'i marrin banesat, e shko ti mbroje banesën". Po keshi se qaq osht', qysh me thanë komike ideja që une kom mujt me mbrojtë çkado, po une qashtu jom nisë normal. Edhe pa as ni ide që ajo osht' krejt kështu la-la. Po u pata kthy. U kon' si me thonë dita e shtatë, tetë mas, mas 19, 18-19 qershori, [1999] a. Shkretinë totale. Shumë pak njerëz, shumë pak sene... për pak s'po di. Qaty e kom kuptu sa osht' jetë tjetër, se shkojsha prej Dardanisë në Breg të Diellit te ni shok që edhe familja e tij që kishin mbetë në, gjatë luftës në Prishtinë.

Edhe eca edhe tash t'u e kapërcy rrugën aty menza, konviktet... po kalon ni kerr ashtu shpejtë. Edhe a din ashtu tytyt [onomatope] kishe, "A çfarë femne?!" Edhe une veç jom kthy edhe ja kom bo qështu {e çon gishin e mesëm} edhe s'kom menu hiç për qat' pune. Kom vazhdu me ecë edhe veç kur e kom pa qat' kerr t'u u kthy në parkingun t'cilin tash unë e kalojsha n'kamë. Ashtu, qështu t'u ma bo me gisht {duke e qortu me gishtin tregues}, edhe kur e kom pa e kom marrë vesh tani që ky osht' tash mu m'njekë se e kom fy këtë Zot shpije, kushdo që ka qenë. Veç kur t'ia kom nis me ngajtë, nëpër do shkallë ku s'kish ku me m'mrri me kerr. Qaty e kom kuptu që, që krejt botë tjetër, a din, edhe ideja që unë kom mujtë me rujtë shpinë ka qenë hajgare.

**Aurela Kadriu:** Qysh e ki gjetë shpinë?

**Jehona Gjurgjeala:** Të vjedhun, të vjedhun. Po, po menoj kurgjo diçka që e vlen m'u përmend.

**Aurela Kadriu:** Mandej mas kësaj a jonë kthy familja a çka ka ndodhë?

**Jehona Gjurgjeala:** Po, jonë kthy. Po munohna me kujtu, po m'doket babi u kthy mjaft shpejtë. Nana ashtu kështu ka qenë t'u dhonë mësim në Fakultet të Mjekësisë në sistemin paralel. Une kom pasë punu për Ambasadën Britanike. Hala isha në shkollë, kështu që hala isha këtu veç gjatë verës. Verën e parë kom punu për Ambasadën Britanike edhe për KFOR-in britanik. Mandej e kom kry fakultetin edhe jom kthy.

**Aurela Kadriu:** E çka ke bo kur je kthy?

**Jehona Gjurgjeala:** Kom punu për ni organizatë lokale. Edhe mandej ni organizatë ndërkombtare, qështu OJQ-ja. Pata studiu shkencë politike, edhe kom pasë studiu shkencë politike se prej “Postpesimistave” u pata infektu me idenë, me, me, me bo ndrrime shoqnore ose me bo diçka për shoqinë, se para asaj kom dashtë m’u bo mjeke, si nana. Domethonë kom studiu shkencë politike edhe mendojsha që ndrrohen senet nëpërmes OJQ-ve. Edhe kom punu në dy OJQ, edhe ka qenë periudhë bajagi e gërditshme, se ka pasë shumë pare edhe ka pasë shumë materializëm edhe për mu ka qenë qaq hipokritike kejt ai sen që pata, pata dalë domethonë, s’kom mujt me përballu. Manej kom shku me magjistru, e qështu.

**Aurela Kadriu:** Ke bo master prapë në Londër, mandej a je kthy prapë, prej ni jetës krejt tjetër?

**Jehona Gjurgjeala:** Jom kthy prapë, edhe qysh me thonë me qët’ procesin e eliminimit, nëse ti don me ndiku n’shoqni, cilat jonë domethonë mundësitë e tua? Organizatë lokale? Jo. Organizatë ndërkombtare? Ehee. Parti politike? Kjo ka qenë eksperimenti i rradhës. Edhe ajo domethonë ka qenë ni mësim. Krejt kanë qenë mësimë shumë t’mira. Kjo ka qenë edhe njo prej atyne. Edhe qaty kom pasë vendosë, domethonë, në “ORA” pata mësu tri sene shumë me randësi. Kjo osht’ 2005-ta. 2004-ta, po 2005-ta. Kosova ka m’u bo ma keq para se m’u bo mirë; nëse don me bo diçka në Kosovë nuk guxon me pasë bishtin e nxont; edhe tre: qëkjo shanca e gjeneratës, shanca e fundit e asaj gjeneratës, po flas për Veton Surroin, e asi, nuk osht’ e mjaftushme.

Edhe qajo ka qenë vend... arsya pse e kom marrë vendimin me shku në perëndim, për me hekë bishtin prej derës. Nuk e kom pasë bishtin prej derës, nxanun, se kom qenë shumë e re me qenë e randësishme, po e kom kuptu që në qoftëse s’ki kujdes në Kosovë, t’shtin me ni territ, qysh me thonë, me ni hapsirë shumë territoriale, gjithkush don me pasë klanin e vet, n’fisn e vet, n’territorin e vet. E nëse don me bo çka ti menon që duhet me bo s’guxon me leju me ra në mëshirë të kërkujt. Edhe për qata kom shku jashtë, kom bo përvojë, përvojë e cila mu ma mundëson kurdo m’u kthy në perëndim nëse du. Kom marrë shtetsinë britanike edhe e kom ble ni banesë me do kursime t’killafta.

**Aurela Kadriu:** Edhe kur u ktheve në Kosovë mandej?

**Jehona Gjurgjeala:** O për mu osht’ shumë okej se i kom mësu mësimet prej krejt qëtyne përvojave t’mia.

**Aurela Kadriu:** Çka ke bo mandej kur u ktheve?

**Jehona Gjurgjeala:** Tash...

**Aurela Kadriu:** Çka je t’u bo tash?

**Jehona Gjurgjeala:** ... po menoj qëky kthimi jem i fundit osht’ para dy vjet e gjysë. Une veç e pata vendosë. Kqyre kanë ndodhë shumë përvoja përpos “Postpesimistave”, ku domethonë qëky aspekti i punës me rininë, edukimi jo-formal, fuqizimi i rinisë, ta gjejnë si prej përvojave t’mia personale si prej

përvojave tjera që i kom pa, ma shumë si observuse i kom pa sa ka fuqi observative. E kom pasë veç idenë nja tri vjet para se m'u kthy që qëkjo o qajo që po du me bo. Domethonë me punu me t'ri, me investu në emancipimin dhe edukimin e tyre, me i motivu ata me iu ndihmu tjerëve.

Mandej qysh osht formsu.... E kom pasë domethonë, e kom ditë që po du me bo qësi edukimi jo-formal, i cili osht' zbavitës, shoqërus, sfidus, osht' i larmishëm edhe ia kom nisë me projektin e parë. Gjashtë muajt e parë s'kom, po meno j kom qenë veç vet edhe kom qenë, domethonë s'e kom pagu veten se s'kom pasë. Domethonë kur e nisë ni organizatë prej zeros që nuk osht' e themelume prej Ambasadës Norvegjeze ose Ambasadës Amerikane, ose cilitdo institucion, s'munesh me pagu veten, veç i grah.

**Aurela Kadriu:** Nëse nuk ki diçka me shtu besoj që qëtash mujna me përmbyllë. Falemnderit!

**Jehona Gjurgjeala:** Okej, falemnderit.